



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 08 . 03 .2024

Lënda: Kërkesë për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes.

Drejtuar: Znj. Holta ZAÇAJ
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

Tiranë

Znj. Kryetare,

Në datën 01.03.2024, 33 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), kanë kërkuar:

- (i) Shfuqizimin e Ligjit nr. 106/2023 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”;
- (ii) Pezullimin e Ligjit nr. 106/2023 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”.

Në përmbajtje të kërkesës për shfuqizimin dhe pezullimin e Ligjit nr. 106/2023 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8891/2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, kërkuarit kanë arsyetuar se ky ligj sjell pasoja që prekin drejtpërdrejtë të drejtën kushtetuese të deputetëve të pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve) për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare. Kjo pasi nëpërmjet këtij ligji jo vetëm ngritja e komisioneve hetimore të Kuvendit është tërësisht në vullnetin e mazhorancës, por edhe në rastet kur një kërkesë do të pranohej, hetimi parlamentar është nën kontrollin e mazhorancës, nëpërmjet pengesave që mund të krijohen duke përdorur forcën e kartonit të shumicës.

Hetimi parlamentar është jo vetëm një e drejtë e garantuar nga neni 77, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, e deputetëve të pakicës parlamentare, por edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit të Shqipërisë që lidhet me ushtrimin e kontrollit efektiv të qeverisjes. Funksioni kontrollues i Kuvendit është mishërimi në praktikë i parimit të ndarjes së pushteteve (shih nenin 7 të Kushtetutës), i cili garanton që Kuvendi të monitorojë dhe kontrollojë mënyrën se si pushteti ekzekutiv vë në zbatim kuadrin ligjor të miratuar nga Parlamenti. Që kontrolli i Kuvendit të jetë efektiv, Kushtetuta dhe Rregullorja i njohin atij një sërë mekanizmesh ligjorë, ku përfshihen seancat e pyetjeve, mocionet e debateve parlamentare, interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore etj. Ndër mjetet më të rëndësishme të kontrollit parlamentar mbi qeverisjen mbetet ngritja e komisioneve hetimore për shqyrtimin e çështjeve të veçanta, nëpërmjet të cilit kontrollohet zbatimi i ligjeve, nxirren përgjegjësitë institucionale, vlerësohet nevoja për

[shqiptari

[shq

shqiptaria.com]

[shqiptaria.com]

[shqiptaria.com]